



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Nr. 1743 Prot.



**PROJEKTVENDIM**

Nr. 30 datë 28/05/2026

**“PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË DEBITORVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE PËR PERIUDHAT 2011- 2014, 2015 – 2019, 2020 – 2024, TË CILËT PËRFITOJNË NGA LIGJI 86/2025 “PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE E VENDORE DHE DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË”**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 86/2025 “Për Fshirjen, Shuarjen dhe Pagesën e Detyrimeve Tatimore ndaj Administratës Tatimore Qendrore e Vendore dhe Detyrimeve të Pagueshme në Doganë”, Udhëzimit nr. 11, datë 14/05/2026 “Për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”, urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 114, datë 15/05/2026, grupi i punës,

**PROPOZON:**

1. Miratimin e listës së taksapaguesve individ dhe biznes me detyrime për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **39,118,458.4 (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë katër) lekë**, për periudhat deri më 31.12.2014, që fshihen plotësisht (pa kusht).
2. Miratimin e listës së tatimpaguesve Biznes të çregjistruar me detyrime tatimore në vlerën **32,371.04 lekë**, për periudhat deri më 31.12.2024, që fshihen plotësisht (pa kusht).
3. Miratimin e listës së tatimpaguesve individ dhe biznes për periudhën **2015–2019** në vlerën **61,992,261.51 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë**, të cilët përfitojnë shuarje pjesore me kusht:
  - a. 50% deri më 30.06.2026
  - b. 25% deri më 31.12.2026

4. Miratimin e listës së tatimpaguesve individ dhe biznes për periudhën 2020–2024 në vlerën **122,999,159.99 (njëqind e njëzet e dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë**, me fshirjen e gjobave dhe kamatëvonesave, duke paguar 100% të principalit deri më 31.12.2026.
5. Pas miratimit të këtij projekt vendimi ngarkohen për zbatim Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.

Bashkëlidhur projektvendimit gjenden listat e debitorëve për kategoritë biznes/individ të ndara sipas periudhave përkatëse.

#### GRUPI I PUNËS

Juela Shpata



Mimoza Shtëmbari



Çajup Refitaj




Endrit Adushaj



Nurkë Hazizaj



Nikoleta Shehaj



Ardi Rrapaj

